



2016 - RREGULLORE E POSAÇME PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE NË AUTO DHE KARTING SPORTE

Në bazë të statutit të Federatës së Auto Sporteve të Kosovës, Bordi ekzekutivë i FASK-ut në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më 02.04.2016 miraton këtë:

RREGULLORE TË POSAÇME PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE NË AUTO DHE KARTING SPORTE

Neni 1

Në Rregulloren e Posaçme për përgjegjësinë disiplinore në auto dhe karting sporte të Federatës së Auto Sporteve të Kosovës, përcaktohen shkeljet disiplinore, organet për mbajtjen e procedurës disiplinore, mënyra dhe afatet e paraqitjes së kërkesës për iniciimin dhe mbajtjen e procedurës disiplinore, personat e autorizuar për paraqitjen e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, përmbajtja e kërkesës, mënyra e mbajtjes (zhvillimit) të procedurës, llojet dhe niveli i masave disiplinore, evidencat e masave të shqiptuara disiplinore, mënyra e shpalljes së masave definitive si dhe shpenzimet e procedurës disiplinore.

Neni 2

Shkeljet disiplinore janë cenimet e dispozitave të Rregullores për auto dhe karting sporte të FASK-ut, rregulloreve të posaçme, rregulloreve shtesë, rregulloreve të garave si dhe të rregulloreve të punës me anë të të cilave rregullohet puna e organeve dhe të trupave të FASK-ut si dhe të delegatëve në gara në auto sporte.

Neni 3

Organizatorët e garave dhe personat e tjerë juridik i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore në rast se deri te shkelja disiplinore ka ardhur me veprimin ose lëshimin e veprimit, përkatësisht mbikqytjen me detyrë nga ana e organit udhëheqës ose personit përgjegjës ose me veprimin e personit tjetër që ka qenë i autorizuar të veprojë në emër dhe në llogari të personit juridik. Përgjegjësia e personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë e personit përgjegjës.

Neni 4

Askush nuk mund të dënohet para se të merret në pyetje, përpos në qoftë se pa shkak të arsyeshëm nuk i përgjigjet ftesës për t'u marrë në pyetje. Konsiderohet se dikush është marrë në pyetje/është dëgjuar në qoftë se pas ftesës së organit kompetent disiplinor dërgon deklaratën e vet me shkrim në afat të kërkuar.

Neni 5

Përgjegjësia penale, respektivisht përgjegjësia kundërvajtëse nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore.

Neni 6

Tentativa e shkeljes disiplinore do të dënohet më lehtë se sa shkelja e shkaktuar.



Neni 7

Personi i cili e nxitë tjetrin ose ia ofron ndihmën për ta kryerë shkeljen disiplinore, do të dënohet sikur ai vet ta kishte bërë shkeljen.

Neni 8

Procedura disiplinore kundër garuesve për shkeljet lidhur me garat e Kampionatit të Kosovës, mund të inicohet më së voni gjer te miratimi-shpallja e rezultateve të Kampionatit të vitit brenda të cilit është kryerë shkelja disiplinore.
Pas shpalljes së Kampionatit, procedura disiplinore nuk mund të nisët e as të mbahet (zhvillohet).

Neni 9

Për dënimet e shqiptuara do të mbahet evidenca e përhershme në FASK.

ORGANET DISIPLINORE

Neni 10

Organi disiplinor i shkallës së parë në auto dhe karting sporte është Gjyqtari disiplinor. Organi disiplinor i shkallës së dytë është Komisioni disiplinor i përberë nga tre anëtar. Vendimi për emërimin dhe shkarkimin e Gjyqtarëve disiplinor e ka Bordi ekzekutivë i FASK-ut.

Neni 11

Për Gjyqtar disiplinor mund të emërohet vetëm funksioneri aktiv i sportit të rangut përkatës që posedon licencën e vlefshme (valide). Vendimin për zgjedhjen dhe emërimin, gjegjësisht shkarkimin e Gjyqtarëve disiplinor e merr Bordi ekzekutiv. Gjyqtari disiplinor, gjatë ushtrimit të funksionit, nuk mund të ushtrojë asnjë funksione ekzekutiv apo mbikqyrës në garat e rangut përkatës në degën e sportit ku e ushtron funksionin e Gjyqtarit disiplinor.

Neni 12

Organi i shkallës së dytë disiplinor i ka tre anëtarë që vendosin në mënyrë të barabartë. Komisioni disiplinor procedon kryesisht sipas dokumentacionit të procedurës së shkallës së parë dhe në bazë të materialit të bashkagjitur ankesës.
Komisioni disiplinor procedon (vepron) pa prezencën e palëve.
Vendimi i organit të shkallës së dytë disiplinore mirëtohet me shumicën e votave të anëtarëve prezent.
Në punën e organit të shkallës së dytë disiplinore detyrimisht merr pjesë edhe Gjyqtari disiplinor i cili e ka dhe vendimin si raportues.



Neni 13

Organet e shkallës së parë dhe të dytë disiplinor të FASK-ut marrin vendim për shkeljet disiplinore të shkaktuara në të gjitha garat nacionale. Kjo vlen për të gjithë anëtarët e FASK-ut që kanë licenca të FASK-ut, gjate gjithë kohës.

Neni 14

Procedurat disiplinore rreth shkeljeve të shkaktuara në nivelet regjionale dhe në rang më të ulët, e zhvillojnë organet përkatëse të atij niveli dhe auto klubet.

Neni 15.

Organet disiplinore në punën e tyre janë të pavarura dhe vendimet i marrin në bazë të fakteve të vërtetuara e në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje të posaçme, Rregullores për auto dhe karting sporte të FASK-ut, rregulloreve të posaçme dhe Shtesave, si dhe në bazë të rregulloreve ndërkombëtare të sportit.

Neni 16

Të gjitha shënimet që kanë të bëjnë me procedurat disiplinore, pas marrjes së vendimit për iniciimin dhe mbajtjen e procedurës, paraqesin fshehtësi zyrtare gjer tek përfundimi i procedurës, përhir të mbrojtjes të interesave si të paraqitësit të denoncimit ashtu edhe të personit kundër të cilit zhvillohet procedura disiplinore.

KËRKESË PËR INICIMIN (HAPJEN) E PROCEDURËS DISIPLINORE

Neni 17

Kërkesën për iniciimin (hapjen) e procedurës disiplinore kundër garuesve, vozitësve, funksionerëve sportiv si dhe ndaj prindërve të garuesve të mitur, respektivisht personave që ndodhen në kuadër të ekipit të garuesve në çfarëdo cilësie, Gjyqtarit disiplinor mund ta paraqesin:

- Forumet sportive dhe organet ekzekutive të FASK-ut
- Komisioni sportiv i garave
- Funksionerët ekzekutiv të garave
- Delegatët e garave
- Garuesit-voztësit pjesëmarrës në gara
- Komisari teknik
- Të gjithë të tjerët që posedojnë licenca të FASK-ut dhe janë pjesëmarrës në gara.

Neni 18

Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore kundër organizatorit të garave, organeve të FASK-ut dhe ndaj personave tjerë juridik, Gjyqtarit disiplinor mund t'i paraqesin:

- Forumet sportive dhe organet ekzekutive të Klubeve, FASK-u



- Komisioni sportiv i garave
- Delegatët e garave
- Garuesit dhe vozitësit - pjesëmarrës në gara
- Komisari teknik
- Të gjithë të tjerët që posedojnë licenca dhe janë pjesëmarrës në gara.

Neni 19

Kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore duhet të paraqitet në afat prej tetë (8) ditësh nga dita kur është marrë vesh (është bërë e njohur) për shkeljen disiplinore, respektivisht për shkaktarin. Kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore e paraqitur në emër të personit juridik duhet të jetë i legalizuar sipas rregullave, duhet ta ketë autorizimin e lëshuar nga ana e personit juridik për paraqitjen e kërkesës për iniciim ose pjesëmarrje në procedurën disiplinore.

Neni 20

Kërkesa për nisjen e procedurës disiplinore duhet që të jetë i formuluar qartë dhe pa dyshim i arsyetuar dhe i dokumentuar (pos materialit në formë të shkruar, mund të shfrytëzohet edhe video xhirimi si material provues në të duhet shënuar saktësisht kundër kujt paraqitet kërkesa dhe për çfarë shkelje disiplinore, me dokumentacion të obligueshëm përcjellës, material provues.

Neni 21

Gjyqtari disiplinor me vendim do ta hudh poshtë çdo kërkesë që është e pakohshme, e pa bazë, paarsyetueshme dhe e padokumentuar si dhe atë të paraqitur nga ana e personit të paautorizuar.

ECURIA E PROCEDURËS DISIPLINORE

Neni 22

Pas pranimit të kërkesës për nisjen e procedurës disiplinore, Gjyqtari disiplinor, po që se nuk ka marrë vendim për ta hudhur poshtë, merr vendim për mbajtjen e procedurës disiplinore dhe vendos për shqiptimin e masës së përkohshme të pezullimit (suspendimit), në rast se për këtë janë pjekur kushtet, në të gjitha apo në disiplinën përkatëse. Kundër vendimit për pezullim (suspendim) nuk është e lejuar ankesa.

Neni 23

Gjyqtari disiplinor gjithmonë do ta shqiptojë suspendimin atëherë kur vlerëson se kjo është e domosdoshme për hir të mbajtjes së papenguar të procedurës disiplinore dhe zhvillimit normal të sistemit të garave, ndërsa deklaratimet në kërkesë ofrojnë bazë për këtë. Gjyqtari disiplinor gjithmonë do ta shqiptojë masën e suspendimit në të gjitha raste kur merr vendim për mbajtjen e procedurës disiplinore për shkeljet nga nenet 42 pika 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje të Posaçme.



Neni 24

Gjyqtari disiplinor është i obligueshëm që të vendos më së shpejti (me urgjencë) për nisjen e procedurës disiplinore, kurse për shqiptimin eventual të suspendimit në afat prej 5 (pesë) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Gjyqtari disiplinor ka për detyrë që ta përmbyll procedurën disiplinore në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit për nisjen dhe mbajtjen e procedurës.

E gjithë korespondenca me personat që në çfarëdo cilësie paraqiten në procedurën disiplinore, zhvillohet me shkrim përmes klubit amë, duke shfrytëzuar me këtë rast letrën me fletëkthesë.

Neni 25

Gjyqtari disiplinor i cili e ka shqiptuar suspendimin pas pranimit të kërkesës për nisjen e procedurës disiplinore, është i detyruar që në afat prej 30 ditësh nga dita e shqiptimit të suspendimit, të vendos në procedurën disiplinore, ose të marrë vendim për anulimin/heqjen e suspendimit.

Neni 26

Koha e kaluar nën suspendim llogaritet në kuadër të masës së shqiptuar disiplinore, në rast se është shqiptuar me kohëzgjatje.

Në rast të shqiptimit të masës disiplinore ndalimi i pjesëmarrjes ose të ushtrimit të funksionit gjatë një numri të caktuar të garave dhe në disiplinat e caktuara, në masën e shqiptuar disiplinore do të llogaritet vetëm numri i garave të disiplinës për të cilën është shqiptuar masa e që ka kaluar gjatë suspendimit.

Neni 27

Pas marrjes së vendimit për mbajtjen e procedurës disiplinore, Gjyqtari disiplinor ia dërgon një kopje të kërkesës për nisjen e procedurës disiplinore me shtojca të duhura personit, kundër të cilit e ka nisur procedurën disiplinore, duke e thirrur që të deklarohej me shkrim për të gjitha rrethanat që iu vihen në barrë.

Përfundimisht, Gjyqtari disiplinor mund ta marrë në pyetje të pandehurin me procesverbal, po qe se kjo shkon në dobi të mbrojtjes racionale të procedurës.

Neni 28

Personit kundër të cilit ka nisur procedurën, Gjyqtari disiplinor ia lë një afat prej 5 ditësh që të deklarohej lidhur me faktet dhe rrethanat që iu vihen në barrë.

Me kalimin e kohës së cekur në paragrafin paraprak, Gjyqtari disiplinor nxjerr edhe provat tjera të nevojshme që janë të domosdoshme për vërtetimin e ekzistimit apo jo të përgjegjësisë të të pandehurit.

Pas mbarimit të procedurës së provave, Gjyqtari disiplinor merr vendimin e vet në formë të aktvendimit.



Neni 29

Të gjitha forumet sportive, organet ekzekutive të FASK-ut, të gjithë funksionerët sportiv, garuesit, vozitësit si dhe të gjithë personat e tjerë që kanë marrë pjesë në ndodhinë me rastin e së cilës ka ardhur deri te kërkesa për nisjen e procedurës disiplinore, kanë për detyrë nën kërcënimin disiplinor, t'ia ofrojnë tërë ndihmën e duhur në vërtetimin e fakteve dhe të rrethanave nën të cilat është shkaktuar shkelja disiplinore.

Neni 30

Të gjitha të dhënat në procedurën disiplinore gjer te marrja e vendimit përfundimtar, janë sekret zyrtar.
Personi në të cilin konstatohet se të dhënat e procedurës disiplinore i ka publikuar, i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore.

MASAT DISIPLINORE

Neni 31

Gjyqtari disiplinor, pas mbarimit të procedurës së provave, i vlerëson provat sipas bindjes së vet të lirë, kurse vendimin e merrë në bazë të fakteve të vërtetuara.
Gjyqtari disiplinor është i lidhur me kualifikimin e shkeljes disiplinore të dhënë në kërkesën për nisjen e procedurës disiplinore.
Kualifikimi nga kërkesa është bazë fillestare për mbajtjen e procedurës disiplinore.

Neni 32

Gjyqtari disiplinor me aktvendim do të ndërprejë procedurën disiplinore, në qoftë se gjenë se shkelja disiplinore nuk është shkaktuar ose nuk ka prova kundër personit të pandehur.

Neni 33

Kur vërteton ekzistimin e përgjegjësisë disiplinore dhe se shkelja disiplinore është shkaktuar nga personi kundër të cilit është nisur procedura disiplinore, Gjyqtari disiplinor merr aktvendim me të cilin këtë person e shpallë të përgjegjshëm për shkeljen e shkaktuar dhe ia shqipton masën disiplinore.
Me shqiptimin e masës disiplinore, suspendimi i shqiptuar automatikisht fshihet, e koha, respektivisht numri i garave të kaluara nën suspendim llogaritet në masën disiplinore.

Neni 34

Masat disiplinore për garuesit, vozitësit, funksionerët sportiv dhe personat të tjerë juridik dhe fizik janë: qortimi, qortimi publik me shkrim, gjoba, ndalimi i pjesëmarrjes ose ushtrimit të funksionit në të gjitha apo në garat e caktuara në periudhën e caktuar kohor dhe ndalimi i përjetshëm i pjesëmarrjes apo i ushtrimit të funksioneve në të gjitha garat-diskualifikimi.



Pranë këtyre masave, Gjyqtari disiplinor mund të shqiptojë edhe dënimin me të holla (gjobën) si të dorës së dytë, në se për këtë ekzistojnë shkaqet e arsyeshme.

Neni 35

Masat disiplinore për organizatorët e garave dhe personat e tjerë juridik dhe fizik të angazhuar në organizimin e garave janë: qortimi publik me shkrim, dënimi me të holla (gjoba) dhe ndalimi i organizimit dhe të paraqitjes në garat e caktuara apo në të gjitha në periudhën e caktuar kohor dhe gjoba si dënim i dorës së dytë (shqiptohet detyrimisht pranë qortimit, qortimit publik me shkrim dhe ndalimit të organizimit ose të paraqitjes në gara).

Neni 36

Qortimi dhe qortimi publik me shkrim shqiptohet garuesve, vozitësve, funksionerëve sportiv dhe personave të tjerë fizik dhe juridik për shkeljet e shkaktuara në gara ose në lidhje me garat, respektivisht në seancat e forumeve të FASK-ut që nuk kanë pasoja në ecurinë e garave, por e prishin prestigjin e organizatës të FASK-ut, fryejnë, përbuzinë dhe shpifinë personat e tjerë zyrtarë. Pranë qortimit dhe qortimit publik me shkrim, detyrimisht shqiptohet edhe dënimi në të holla (gjoba) si i dorës së dytë.

Neni 37

Dënimi me të holla shqiptohet garuesve dhe funksionerëve sportiv për sjellje josportive që nuk kanë pasoja qenësore në rrjedhën e garave si dhe për shkak të mosrespektimit të ceremonialit të ndarjes së trofeve sportive në gara dhe ndarja solemne e mirënjohjeve në fund të sezonës së garave nga ana e garuesve dhe të përfaqësuesve të klubeve dhe të ekipeve sponsorëve.

Dënimi me të holla (gjoba) shqiptohet organizatorëve të garave dhe personave të tjerë juridik për: mosmbajtjen e garave të regjistruara në kalendarin e konfirmuar të garave (përveç kur kemi të bëjmë me arsyet e fuqisë madhore); organizimin e bojkotit të ndonjë gare apo të të gjitha garave pa marrë parasysh arsyet; legalizimi i paraqitjeve në gara për automjetet në të cilët konstatohen riparime të ndaluara; legalizimi i paraqitjeve për garuesit që janë nën masa disiplinore; mospërbushja ose përbushja e plotë e obligimeve të marra materiale me rastin e garave; paraqitja jo e vërtetë e ngjarjeve në publik, e sidomos nëpërmjet mjeteve të informimit publik si dhe lëshimet tjera në organizimin e garave që kanë ndikuar ose kanë mundur të kenë ndikim në rregullshmërinë e garave, si dhe për incidentet e shkaktuara në gara me qëllim favorizimi të Klubit të caktuar e që nuk janë të parashikuara në dispozitat e pastajme për dënim.

Neni 38

Dënimi me të holla si masë e dorës së dytë disiplinore, shqiptohet garuesve, funksionerëve sportiv, organizatorëve të garave dhe personave të tyre zyrtarë në gara, prindërve-kujdestarëve, respektivisht mekanikëve ose anëtarëve të ekipit të fëmijëve pjesëmarrës në gara dhe personave të tjerë fizik dhe juridik pranë masave të shqiptuara disiplinore, në qoftë se Gjyqtari disiplinorë vlerëson se për hir të arritjes së qëllimit të masës disiplinore është i nevojshëm shqiptimi i tij.



Neni 39

Lartësinë (nivelinë) e dënimit me të holla, si masë të dorës së dytë disiplinore, nga shkalla minimale e deri te shkalla maksimale e përcakton me vendimin e vet Bordi i FASK-ut në fillim të vitit para se të nis sezona e garave.

Për vitin 2016 janë të përcaktuara këto gjopa:

Për personat fizik në shkallë prej 50 e deri 500 euro dhe

Për personat juridik në shkallë prej 200 euro deri 1000 euro.

Gjobat e shqiptuara paguhen në llogarinë e FASK-ut në afat prej 5 (pesë) ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë dhe të formës së prerë të aktvendimit ndëshkues, duke shënuar detyrimisht për fondin e avancimit (zhvillimi) të sportit.

Neni 40

Mosveprimi sipas dispozitave të paragrafit 2 dhe 3 të nenit 39 të kësaj Rregulloreje të Posaçme, shkakton ndalimin automatik të pjesëmarrjes të të gjithë garuesve dhe funksionerëve sportiv, anëtarë të klubit garuesi i të cilit nuk e ka përmbushur obligimet materiale ndaj FASK-ut.

Neni 41

Dënimet me të holla që shqiptohen në procedurën disiplinore së bashku me shlyerjet nga plasmani janë:

- i). 100 Euro për: Shkeljen e dispozitave të rregulloreve sportive pa pasoja për rrjedhën e garave; Pengimin e punës të seancave të organeve dhe të trupave, të vonuarit në vendin e referimit nga ana e funksionerëve ekzekutiv të garave pa shkaqe të arsyeshme; Mosmbajtja e shenjave në gara.
- ii). 200 Euro për: Sjellje josportive, grindje, sharje, ose sjellje të pahijshme në gara nga paraqitja e kërkesës për gara gjer tek ndarja e shpërblimeve. Të vonuarit e funksionerit mbikqyrës të garave pa shkaqe të arsyeshme, verifikimi i vozitësve në gara pa dokumente të nevojshme; Mos informimin e funksionarit sportiv për incidentin në gara; Mos shkuarja në parkingun e mbyllur apo dalja nga parkingu i mbyllur pa lejen e drejtorit të garës.
- iii). 300 Euro për: Pengimin e garuesve të tjerë në shteg; Shkaktimin e disa shkeljeve në garat e njëjta pa pasoja të mëdha ndaj ecurisë së garave. Shkeljen e qëllimshme të dispozitave të rregulloreve sportive; Paraqitjen në gara të personave që nuk kanë dokumentacionin e plotë të nevojshëm; Paraqitjen në gara pa pëlqime të nevojshme ose lejeve; Sjelljen josportive.
- iv). 400 Euro për: Sjelljet josportive në garat jashtë vendit. Tentimin e sulmit fizik ndaj garuesit apo funksionarit sportiv; Mosparaqitjen e ekzistimit të shkeljes disiplinore dhe të shkaktarit; Shkeljen e shumëfishtë me qëllim të dispozitave të rregulloreve sportive.



v). 500 Euro për: Largimin demonstrativ nga garat; Dëshmimin e rremë në procedurën disiplinore; Nxitjen e dëshmitarit në procedurën disiplinore për ta ndryshuar ndërruar deklaratën e dhënë. Keqpërdorimin e funksionit zgjedhor dhe trupat e organizatës së FASK-ut.

Neni 42

Ndalimin e pjesëmarrjes dhe ndalimin e kryerjes së funksionit në gara e shqipton Gjyqtari disiplinor garuesve, vozitësve, funksionerëve sportiv dhe personave të tjerë fizik;

1. Gjer në 3 muaj ose gjer në tri gara për: sulmin fizik të garuesve ndaj garuesve të tjerë; shkeljen e dispozitave të rregulloreve të sportit; animin dhe joobjektivitetin në punë; riparimet e ndaluara të automjeteve me vëllim të mesëm; mosparaqitjen e ekzistimit të shkeljes disiplinore dhe për shkaktarin nga ana e personave zyrtarë të garave; mosrespektimin e sinjalizimeve në shtegun gjatë garave në rast se kjo ka shkaktuar pasoja materiale të vëllimi më të madh ose e ka rrezikuar jetën e personave zyrtarë dhe të publikut. Gjetja e sasisë se palejuar të alkoolit në organizëm nga 0.2 deri ne 0.5 promilë.

2. Prej 4 e gjer në 6 muaj ose prej 4 gjer në 6 gara për paraqitjen e pavërtetë të ngjarjeve në publikë; braktisjen e funksionit gjatë garave pa shkaqe të arsyshme; shkeljet e rregulloreve lidhur me afatin kalimtar; paraqitjen në gara në çfarëdo cilësie gjatë kohës sa është në fuqi ndalimi i shqiptuar; Riparimet e ndaluara me vëllim më të madhe; gabimet e rënda të funksionerëve të sportit që kanë ndikim në plasman. Gjetja e sasisë se palejuar të alkoolit në organizëm mbi 0.5 promilë.

3. Prej 7 e gjer në 12 muaj ose prej 7 e gjer në 12 gara për: paraqitjen e pavërtetë të ngjarjeve në mjetet e informimit; ofendimin dhe shpifjen ndaj forumeve sportive dhe funksionerëve; gabimet e rënda në punën e funksionerëve ekzskutiv të sportit me pasoja në pengimin e zhvillimit normal të garave; paraqitjen në gara ose ushtrimin e funksionit për kohën derisa është në fuqi suspendimi ose masa disiplinore; braktisjen e funksionit gjatë garave; dhënien apo marrjen e mitos; vënien në pah të të dhënave përkritazi me procedurën disiplinore para se të jetë mbyllur procedura; mosmundësimin e kontrollimit të automjetit sipas kundërshtimit ose kërkesës të delegatit teknik; falsifikimin e dokumenteve në gara (licencën procesverbalet, kartelat kohore etj). Refuzimi i bërjes së alko-testit.

4. Prej 13 e gjer në 24 muaj ose prej 13 e gjer në 24 gara për: sulmin fizik ndaj funksionerit sportiv ekzekutiv apo mbikqyrës; vozitjen e rrezikshme që si pasojë ka fatkeqësinë që plotësisht e ndërprejë garën; organizimin dhe zbatimin e bojkotit të garave apo të mbledhjeve të forumeve sportive; sjelljet që e dëmtojnë auto dhe karting sportin; modifikimet e ndaluara me performanca tepër te larta; kundërshtimi i kontrollit teknik te veturës apo kartingut.

Neni 43

Ndalimin e organizimit ose të pjesëmarrjes në gara Gjyqtari disiplinor u shqipton organizatorëve të garave ose personave të tjerë juridik:

Gjer në 12 muaj për: paraqitjen në gara ose pranimin në gara të garuesve dhe vozitësve që nuk kanë lejet e duhura, që janë të suspenduar ose kanë ndalesë të pjesëmarrjes, ata që nuk kanë përmbushur



obligimet materiale sipas vendimeve të organeve të FASK-ut; të cilët pas vërtetimit të Rregullores së garës kanë anuluar organizimin e garës.

Prej 13 e gjer në 24 muaj për: shkeljet e rregulloreve të sportit që si pasojë kanë jorregullshmërinë e zhvillimit të garave ose ndërprerjen e tyre; anulimin e garave pa arsye reale ose jashta termineve të caktuara; mosekzistimin e dokumentacionit të nevojshëm për organizimin dhe zhvillimin e garave, sigurimin e dobët, respektivisht jo të plotë e të ngjashme.

Neni 44

Gjoha në të holla në shume deri në 1000 Euro, si dënim dytësor mund të shqiptohet klubeve për kryerjen e shkeljeve të përmendur në nenin 43.

Neni 45

DISKUALIFIKIMI shqiptohet vozitësve, garuesve, funksionerëve sportiv dhe personave të tjerë fizik dhe juridik për: shkeljet veçanërisht të rënda të dispozitave të rregulloreve të sportit që kanë shkaktuar pasoja të rënda në gara; refuzimi këmbëngulës të kryerjes së urdhërave të funksionerëve ekzekutiv sportiv për ç'shkak ka ardhur deri te fatkeqësia në gara me pasoja të rënda; gabimet e rënda të funksionerëve ekzekutiv sportiv që shkaktojnë pasoja të rënda dhe fatkeqësi në gara e të ngjashme.

Kjo masë disiplinore mund t'u shqiptohet garuesve, vozitësve, funksionerëve sportiv dhe personave të tjerë fizik dhe juridik edhe në rastin e përsëritjes së shumëfishtë të shkeljeve të rënda disiplinore.

Neni 46

Në qoftë se shkeljen e rregulloreve të sportit e shkakton shtetasi i huaj me licence te FASK-ut, masa disiplinore do të shqiptohet si të ishte në pyetje shtetasi vendas, kurse për këtë do të lajmërohet ASN e personit i cili e ka shkaktuar shkeljen respektivisht ASN që edhe e ka dhënë pëlqimin për të poseduar licencë të FASK-ut.

Në qoftë se shkeljen e rregulloreve të sportit e shkakton shtetasi i huaj me licence te huaj për këtë ASN e cila e ka lëshuar licencën do të informohet për veprën e kryer me propozim për të iniciimin e procedurës disiplinore.

Neni 47

Gjatë shqyrtimit të masës disiplinore ndaj shkaktarit të shkeljes, do të merren parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe nivelin e masës disiplinore, si rënduese ashtu edhe lehtësuese. Sidomos do të vlerësohen: pasojat e shkaktuara, niveli i përgjegjësisë së shkaktarit, motivi dhe mënyra se si është shkaktuar shkelja, vetitë morale të shkaktarit, sjellja dhe qëndrimi i tij para, pas shkakimit të shkeljes, e posaçërisht gjatë kohës së mbajtjes së procedurës disiplinore.



Neni 48

Në rast të shkaktimit të më shumë shkeljeve, Gjyqtari disiplinor më parë konstaton masën disiplinore për çdo shkelje veç e veç, e pastaj shqipton masën unike disiplinore. Masa unike disiplinore e shqiptuar nuk mund të jetë më e vogël e as të tejkalojë nivelin e dyfishtë të masës më të rëndë të konstatuar.

Neni 49

Masa unike disiplinore e shqiptuar duhet posaçërisht të ceket në aktvendim, pastaj rangu i garave si dhe dega, respektivisht disiplina e auto sportit së cilës i përket ndalimi. Gjyqtari disiplinor nuk mund ta shqiptojë masën në kohëzgjatje, nëse më tepër se një çerek (1/4) e masës disiplinore kalon në kohën jashtë sezone.

Neni 50

Masa disiplinore në numër të garave dhe në kohëzgjatje mund të shqiptohet për Kampionatin e Kosovës dhe atë për degën, disiplinën ose për të gjitha degët ose për të gjitha disiplinat e auto dhe karting sportit.

Po qe se është konstatuar shkelja, pjesëmarrja me automjetin ku janë ndërmarrë riparimet e palejuara, masa disiplinore shqiptohet vetëm për rangun e garave dhe për disiplinën ku është shkaktuar shkelja.

Neni 51

Në rast se është shqiptuar masa e ndalimit të pjesëmarrjes ose të ushtrimit të funksionit në numrin e caktuar të garave, në masën disiplinore do të llogariten vetëm garat me rangun, degën dhe disiplinën për të cilët është shqiptuar masa.

Neni 52

Gara nga e cila është larguar garuesi, vozitësi apo funksioneri sportiv dhe për shkak të së cilës është mbajtur procedura disiplinore, nuk do të llogaritet në numrat e garave që kanë të bëjnë me masën e shqiptuar disiplinore ndalimin e pjesëmarrjes ose ushtrimit të funksionit.

Neni 53

Në qoftë se gjatë shqyrtimit të masës disiplinore konstatohet që nuk janë shkaktuar pasojat e rënda dhe që ekzistojnë rrethanat e veçanta lehtësuese që dëftojnë se edhe me vetëm kërcënim me masë disiplinore mund të arrihet qëllimi i dënimit, shkaktarit të shkeljes mund t'ju shqiptohet masa disiplinore me kusht.

Me shqiptimin e masës disiplinore me kusht, shkaktarit i konstatohet zgjatja e masës disiplinore dhe në të njëjtën kohë do të përcaktohet se ajo nuk do të ekzekutohet me kusht që shkaktari në kohën e lënë të mos shkaktojë shkelje të re.

Afati me kusht për masën disiplinore të kushtëzuar nuk mund të jetë më i shkurtër se gjashtë muaj e as më i gjatë se 12 muaj.



SHPENZIMET E PROCEDURËS DISIPLINORE

Neni 54

Shpenzimet e procedurës disiplinore gjer në përfundimin e saj mbulohen nga FASK-u. Për shpenzimet e krijuara gjatë procedurës, Gjyqtari disiplinor mbanë evidencën.

Neni 55

Me rastin e vendimmarrjes në çështjen disiplinore, Gjyqtari disiplinor me vendim do të obligojë pjesëmarrësin në procedurë, varësisht nga përgjegjësia, në kompensimin dhe pagimin e taksave.

Neni 56

Personi (fizik apo juridik) të cilit i është caktuar pagimi i shpenzimeve dhe të taksës nga ana e Gjyqtarit disiplinor, ka për detyrë që këtë ta kryejë në afat prej 5 ditësh. Në të kundërtën, nuk do të mund të paraqitet në garat e ardhshme gjer sa të mos likuideojë obligimet.

Nëse personi fizik nuk e kryen obligimin nga neni paraprak, Klubi për të cilin është i regjistruar, ka për detyrë që në afat prej 5 ditëve në vijim të bëjë këtë nën kërcënim të dënimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin.

ANKESAT DHE ZBUTJA E JASHTËZAKONSHME E MASAVE

Neni 57

Kundër vendimit të Gjyqtarit disiplinor të nxjerrë në shkallën e parë, paraqitësi i kërkesës për nisjen e procedurës disiplinore dhe i pandehuri mund të parashtrojnë ankesë organit kompetent disiplinor të shkallës së dytë.

Në emër të personit të mitur-garuesit, ankesën e parashton prindi, respektivisht kujdestari.

Në emër të personit ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore, ankesën mund ta parashtrojë Klubi i tij amë.

Ankesat duhet të parashtrohen në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit në dorëzim, kurse parashtrohen organit përkatës disiplinor.

Ankesa duhet të jetë qartë e formuluar dhe e arsyetuar si dhe të përmbajë theksimet e dokumentuara që e mohojnë vendimin e shkallës së parë.

Me ankesë, ankuesi detyrimisht dërgon provë për pagesën e kryerë të tërë shumës së taksës të përcaktuar për ankesën.

Ankesa e parashtuar pas afatit të caktuar si dhe ankesa që nuk përmbanë të gjitha elementet dhe nuk ka prova për pagesën e bërë të taksës së caktuar, nuk do të mirret në shqyrtim do të hudhet poshtë nga shkaqet formale.

Neni 58

Të gjitha ankesat duhet të zgjidhen nga ana e organit të shkallës së dytë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim.



2016 - REGULLORE E POSAÇME PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE NË AUTO DHE KARTING SPORTE

Vendimet e marra në shkallën e dytë janë përfundimtare dhe ekzekutive me datën e nxjerrjes së tyre.

Neni 59

Bordi ekzekutiv i FASK-ut, kur për këtë ekzistojnë shkaqet posaçërisht të arsyeshme, mundet që ta zbus në mënyrë të jashtëzakonshme masën përfundimtare disiplinore të shqiptuar.

Kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të masës disiplinore mund ta parashtrijnë: personi i dënuar, forumet sportive, organet ekzekutive të Klubeve.

Zbutja e dënimit nuk mund të jetë më shumë se 50% e dënimit të shqiptuar.

Neni 60

Sekretari i FASK-ut ka për detyrë që ta mbajë evidencën për garuesit për të cilët janë shqiptuar masat disiplinore ose që janë suspenduar nga garat.

Sekretari i FASK-ut ka për detyrë që me kohë t'i dërgojë organizatorëve të garave listën e personave që nuk mund të marrin pjesë në gara pa marrë parasyshë cilësinë.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 61

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje të Posaçme bëhen sipas mënyrës dhe procedurës për miratimin e saj.


Për interpretimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje të Posaçme është kompetent Bordi ekzekutiv i FASK-ut.

Neni 62

Kjo Rregullore e Posaçme hynë në fuqi ditën e aprovimit.

FEDERATA E AUTO SPORTEVE TE KOSOVES




Ismet Rexhepi, Kryetar i FASK-ut